



REPUBLIKA E KOSOVES, REPUBLIKA KOSOVA, REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Pranuar / Dorezuar Prilijeno/Prodato Received/Delivery	01.12.2022	2 viti god year	
Organ /Njesia Organ /Jedinica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKOMSHCK	7584/2022		1/8



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A Nr.859/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës – Kolegji për shqyrtimin e ankesave i përbërë nga; Malsore Gashi – Bajraktari kryetare, Arben Mehmeti dhe Eshref Shabani-anëtar, si dhe Rushit Kajtazi, Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtësit për shqyrtimin e ankesës me numër A. Nr. 859/2022, të datës 04.10.2022, të parashtruar nga ankuesja me adresë banimi nga Hani i Elezit, kundër organit të punësimit Komuna e Hanit të Elezit, në çështjen juridike “kontestim konkursi”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 01.12.2022, mori këtë.

V E N D I M

I. REFUZOHET si e pabazuar ankesa me numër A.nr.859/2022 e datës 04.10.2022, e parashtruar nga ankuesja

II.MBETET NË FUQI, Vendimi me numër protokolli 02-7565/2022 i datës 09.09.2022, i Komisionit të Pranimi në Komunën e Hanit të Elezit.

Arsyetim

Komuna e Hanit të Elezit sipas njoftimit të datës 29.04.2022 ka shpallur konkursin e jashtëm për grupin “Specialistë të Arkitekturës”, për pozitën “Zyrtar për Planifikim dhe Zhvillim”, me numër reference RN000008821 për afatin e aplikimit nga data 20.05.2022 deri më 03.06.2022, duke u bazuar në dispozitat e nenit 34 paragrafi 2 dhe 3 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë dhe nenit 7 dhe 9 të Rregullores (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës.

Ankuesja me datë 03.06.2021 ka aplikuar në konkursin e shpallur nga Komuna e Hanit të Elezit i publikuar sipas njoftimit të datës 29.04.2022 për grupin “Specialistë

të Arkitekturës " për pozitën "Zyrtar për Planifikim dhe Zhvillim", me nr. reference RN000008821 në të cilën procedurë ankuesja ka qenë e përfshirë në të gjitha fazat e rekrutimit dhe pas intervistës me gojë ankuesja është njoftuar me datë 01.09.2022 lidhur me pikët e arritura ,gjithsejtë 68.78 pikë, duke u renditur e dyta në listën përfundimtare.

E pa kënaqur me Vendimin e datës 01.09.2022 ankuesja më datën 02.09.2022 ka parashtruar ankesë me numër protokolli 02/7296 tek Komisioni për pranim në shërbimin civil për pozitën "Zyrtar për Planifikim dhe Zhvillim", me pretendim ankimor se procedura e rekrutimit për pozitën e lartë cekur është zhvilluar në kundërshtim me legjislacionin në fuqi.

Komisioni për pranim në shërbimin civil për pozitën " Zyrtar për Planifikim dhe Zhvillim" më datë 07.09.2022 nxjerr Vendimin me numër protokolli 02/7567/2022, gjegjësisht me datë 09.09.2022 e korrigjon Vendimin e njëjtë për shkaqe teknike lidhur me ankesën me nr.02/7296 të parashtruar nga ankuesja, me të cilin vendim e refuzon ankesën e ankueses së lartpërmendur dhe lenë në fuqi Vlerësimin e Komisionit për Pranim dhe renditjen përfundimtare të kandidatëve.

Ankuesja e pakënaqur me Vendimin me numër protokolli 02/7567/2022 të datës 09.09.2022, të Komisionit të Pranimit, me datën 04.10.2022 ka parashtruar ankesë me numër A.nr.859/2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimet ankimore për anulimin e procedurës së rekrutimit për pozitën „Zyrtar për Planifikim dhe Zhvillim”, në Komunën e Hanit të Elezit.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me datë 07.10.2022 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë me numër protokolli 5949/2022 tek Njësia e Personelit të Komunës Hani i Elezit , ndërsa Këshilli me datë 17.10.2022 ka pranuar përgjigjen në ankesë të protokolluar me numër 3897/2022 së bashku me shkresat e bashkangjitura të lëndës, po ashtu Këshilli me datë 08.10.2022 ka kërkuar prova shtesë tek Njësia e personelit të Komunës Hanit i Elezit ndërsa me datë 10.10.2022 Këshilli ka pranuar provat e kërkuara me numër protokolli me numër 7000/2022.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, me qëllim të vërtetimit të plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike dhe bazës juridike , për marrjen e vendimit meritator ka administruar këto prova: Ankesën A nr. 859/2022, e datës 04.10.2022, drejtuar Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Kërkesë për kthimin e aktit Admirativ i datës 09.09.2022; Vendimi i datës 09.09.2022, i Komisionit të Pranimit; Vendimi i datës 07.09.2022, i Komisionit të Pranimit; Dëshmi për gazetën Insajder; Njoftim për mbajtjen e intervistës e datës 24.08.2022; Renditja përfundimtare e kandidateve e datës 31.08.2022;e- maili i datës 26.08.2022; Njoftimi i datës 01.09.2022, për kandidatin e suksesshëm; Njoftimi i datës 23.06.2022; Vendimi i datës 15.06.2022, për Themelimin e Komisionit të pranimit; Lista e aplikanteve; Rezultati përfundimtar; Konkursi i datës 20.05.2022;Njofetimi i datës 19.03.2021; Aplikacioni i me shkresat e bashkangjitura; Diplomë e datës

29.12.2019; Vërtetim i datës 03.06.2022; Vërtetim i vitit 2019; Kontratë për marrëveshje shërbime të veçanta e datës 02.11.2020; Përgjigje në ankesë e datës 16.06.2022; Njoftimi i datës 10.06.2022; Ankesë e datës 02.09.2022, drejtuar Komisionit të Pranimit; Vlerësimi i testimit me gojë; Aplikacioni i me shkresat e bashkangjitura; Diplomë e datës 08.02.2017; Vërtetim i datës 26.01.2019; Kontratë për shërbime të veçanta i datës 08.04.2021; Kontratë për shërbime të veçanta i datës 14.04.2021; Kontratë për shërbime e datës 22.11.2021; Kontratë për shërbime e datës 12.04.2021; Kontratë për shërbime e datës 30.03.2021; Kontratë për shërbime të veçanta i datës 01.08.2018; Kontratë për shërbime të veçanta e datës 22.08.2020; Kontratë për shërbime të veçanta i datës 05.06.2017; Kontratë për shërbime të veçanta i datës 01.05.2018; Vlerësimi i intervistës me gojë për kandidaten Aplikacioni i me shkresat e bashkangjitura; Diplomë e datës 25.01.2017; Reference e datës 01.09.2018; Njoftimi i datës 10.06.2018; Përgjigjen në ankesë e datës 17.10.2022, me numër protokolli 6247/2022.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, për vendosjen e kësaj çështje, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e bashkangjitura të lëndës, ka konstatuar se ankesa e ankueses është e pa bazuar sepse:

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave sipas shkresave të lëndës ka konstatuar se Komuna e Hanit të Elezit, sipas njoftimit të datës 29.04.2022 ka shpallur konkursin e jashtëm me numër reference RN000008821 për pozitën "Zyrtar për Planifikim dhe Zhvillim", me afat aplikimi nga data 20.05.2022 deri më datën 03.06.2022, duke u bazuar në dispozitat e nenit 34 paragrafi 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9, 10, 11, 12 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë dhe nenit 7 dhe 9 të Rregullores (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës

Ankuesja në ankesën e paraqitur tek Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, pretendon se gjatë zhvillimit të këtij procesi të rekrutimit ka pasur shkelje procedurale dhe ligjore, respektivisht pretendon se ka pasur mos njoftim për rezultate dhe konflikt interesi.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave nga administrimi i shkresave të lëndës ka konstatuar se Komuna e Hanit të Elezit me rastin e shpalljes së konkursit të datës 29.04.2022 për pozitën "Zyrtar për Planifikim dhe Zhvillim" ka përcaktuar kriteret e përgjithshme formale:

- **Arsimi i kërkuar:** Diplomë/a e studimeve Universitare me të paktën 180 kredi/ECTS-së apo ekuivalente me to, në fushën e : arkitekturës dhe zhvillim hapësinor, Urbanistikës
- **Përvoja e punës e kërkuar:** Se paku (2) vite përvoja pune në fushën për të cilën zhvillohet procedura për plotësimin e pozitës së lirë të Punës

Sipas shkresave të lëndës është konstatuar se në konkursin e shpallur nga Komuna Hani i Elezit me numër reference RN000008821 për pozitën "Zyrtar për Planifikim dhe Zhvillim", kanë aplikuar 3 kandidatë, ndërsa 2 prej tyre janë vlerësuar se i plotësojnë kriteret e konkursit të lartcekur gjegjësisht dhe ankuesja është vlerësuar se i plotëson kriteret e konkursit e cila me është përfshirë në listën e ngushtë të datës 20.06.2022, ndërsa me datën 23.06.2022 Zyra e Personelit ka ftuar kandidatet për testin me shkrim me datën 12.07.2022, andaj Kolegji për

shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave ka konstatuar se verifikimi paraprak për kandidatet që ka plotësuar kushtet e konkursit është vlerësim i drejtë, rrjedhimisht Njësia e Burimeve Njerëzore e Komunës së Hanit të Elezit ka vepruar në pajtim me kompetencën e tij të përcaktuar me nenin 15 të Rregullores (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës ku është përcaktuar se *1.Verifikimi paraprak është procesi i verifikimit nëse kandidati plotëson kushtet për aplikim. 2.Verifikimi paraprak kryhet nga Njësia Përgjegjëse, në bazë të dokumenteve të paraqitura si pjesë e aplikimit dhe verifikimeve të tjera sipas detyrës zyrtare që ndërlidhen me verifikimin paraprak. 3.Në përfundim të verifikimit paraprak, Njësia Përgjegjëse përcakton kandidatët që plotësojnë kushtet për aplikim. Vetëm kandidatët që plotësojnë kushtet për aplikim kanë të drejtë të vazhdojnë më tej konkurimin në fazën e mëtejshme, e cila njihet si lista e ngushtë”*.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave gjatë shqyrtimit të provave ka konstatuar se ankuesja e ka kaluar fazën e verifikimit dhe ka marrë pjesë në testin me shkrim, ndërsa me datë 12.07.2022 është njoftuar se ka arritur gjithsejtë 46 pikë nga testi me shkrim dhe është ftuar për intervistë me gojë, pas mbajtjes së intervistës me gojë të datës 31.08.2022 ankuesja është vlerësuar nga Komisioni i pranimit në pajtim me nenin 16 të Rregullores (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, ku është e përcaktuar se: *“ 1.Vlerësimi i kandidatëve kryhet nga Komisioni i Pranimit. i themeluar në pajtim me nenin 17 dhe/ose përkatësisht neni 18 të kësaj Rregulloreje. 2.Vlerësimi i kandidatëve, përfshin, sipas radhës: 2.1. vlerësimin nëpërmjet një testimi me shkrim; 2.2. vlerësimin e jetëshkrimit /CV, dhe 2.3. vlerësimin nëpërmjet një interviste me gojë”, dhe pretendimet e ankuses janë të pa bazuara pasi që në rastin konkret ankuesja me datë 31.08.2022 është njoftuar lidhur me pikët e përgjithshme të arritur me gjithsejtë 68.76 pikë, duke u renditur e dyta në listën përfundimtare.*

Lidhur me pretendimin ankimor të ankuses e cila pretendon se gjatë këtij procesi ka pasur shkelje procedurale tek vlerësimi i testit me shkrim, jetëshkrimi dhe intervista me goje, Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, konstaton se në bazë të nenit 22 paragrafit 1, 2 dhe 4 nën paragrafi 4.1, 4.2, dhe 4.3 të Rregullores (QRK) Nr. 16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, është përcaktuar se: *“1.Pas testimit me shkrim, vlerësimi i kandidatëve vazhdon me vlerësimin e jetëshkrimit. 2.Vetëm kandidatët që kanë marrë të paktën dyzet (40) pikë në testimin me shkrim, i nënshtrohen vlerësimit të jetëshkrimit. 4.Vlerësimi maksimal për jetëshkrimin është deri në njëzet (20) pikë, të ndara, si vijon: 4.1. deri në tetë (8) pikë për cilësinë dhe nivelin të arsimimit; 4.2. deri në shtatë (7) pikë për përvojën domethënëse në punë; dhe 4.3. deri në pesë (5) pikë për trajnimet”,* ndërsa Komisioni i Vlerësimit në bazë të dokumentacioneve ka bërë vlerësimin e jetëshkrimit për kandidatët ku ankuesja është vlerësuar me gjithsejtë 14. 4 pikë ndërsa kandidati i përzgjedhur 17, andaj në këtë rast pretendimi i ankuses është i pabazuar sepse vlerësimi për këtë pjesë është bërë në mënyrë të drejtë, po ashtu sa i përket përpilimit të testit me shkrim Kolegji konstaton se testi është përpiluar në pajtim me dispozitat e Ligjit Nr.6/L-114 për Zyrtarët Publikë dhe të Rregullores (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës. Po ashtu Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, duke i'u referuar nenit 21 paragrafi 3 dhe 4 të Rregullores (QRK) Nr. 16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës ku theksohet se: *“3.Testi me shkrim zhvillohet dhe vlerësohet në mënyrë elektronike. 4.Vlerësimi maksimal i mundshëm për*

*testimin me shkrim është deri ne shtatëdhjetë (70) pikë", konstaton se ne baze te shkesave te lendes poentomi i dy kandidatëve si në testim me shkrim, jetëshkrim është bërë përmes sistemit elektronik/Sistemit për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore (SIMBNJ) dhe se ankuesja nga testi me shkrim ka realizuar gjithsej 46 pikë dhe është njoftuar përmes sistemit elektronik/Sistemit për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore (SIMBNJ) me date 12.07.2022 ndërsa me date 19.08.2022 ankuesja është njoftuar me piket e jetëshkrimit dhe për kalimin në fazën tjetër të vlerësimit gjegjësisht në fazën e intervistës me gojë ashtu siç përcaktohet në paragrafin 2 të nenit 23 të Rregullores (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës ku thuhet se: **" Vetëm kandidatët që kanë marrë të paktën gjashtëdhjetë (60) pikë në dy hapat e para të vlerësimit, kanë të drejtë të marrin pjesë në intervistë me gojë "**, andaj si rrjedhojë pretendimi ankimor i ankueses lidhur me poentimin e saj dhe mos njoftimin e pikëve nga ana e organit të punësimit, është i paqëndrueshëm.*

Ndërsa sa i përket pretendimit ankimor se një anëtar i komisionit të pranimit është ndërruar dhe se po i njëjti Komision nuk i ka bërë vlerësim real dhe të drejtë përgjigjeve të cilat i ka dhënë në intervistën me gojë, Kolegji konstaton se pretendimet e ankueses janë të pa qëndrueshme sepse ankuesja nuk ka arritur që të argumentoj me asnjë prova dhe dëshmi se Komisioni i ka bërë vlerësim të padrejte në krahasim me kandidatin fitues respektivisht Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesës se në bazë dëshmimeve të ofruara konkretisht Vendimit me numër protokoli 02 Nr-4259/22 të datës 15.06.2022 të Kryetarit të Komunës së Hanit të Elezit ka konstatuar Komisioni për pranim në Komunën e Hanit të Elezit është themeluar në pajtim me nenin 34 paragrafin 12, 13 dhe 14 të Ligjit Nr. 06/L - 114 për Zyrtarët Publikë dhe nenin 18 të Rregullores (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, i cili konform këtyre dispozitave ligjore është përgjegjës për zhvillimin e procesit të rekrutimit dhe se i njëjti është i pavarur sa i përket vlerësimit të kandidateve, po ashtu në baze të përgjigjes në ankesë të Njesisë së Burimeve Njerëzore të Komunës së Hanit të Elezit të 17.10.2022 dhe të datës 10.11.2022, është vërtetuar se të dy kandidatët në të gjitha fazat e rekrutimit janë vlerësuar drejtë dhe në pajtim me dispozitat ligjore nga verifikimi paraprak deri tek përzgjedhja përfundimtare gjegjësisht nga vlerësimi i përgjithshëm, vlerësimin nëpërmjet testimit me shkrim, vlerësimit të jetëshkrim, vlerësimit nëpërmjet intervistës me gojë dhe deri tek llogaritja e rezultatit përfundimtar, është zhvilluar në pajtim me dispozitat ligjore të nenit 18, 21, 22, 23 dhe të nenit 24 të Rregullores (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, po ashtu edhe zëvendësimi i anëtarit është bërë në pajtim me nenin 18 paragrafin 6 të Rregullores (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, ku përcaktohet se „ 6. Paragrafët 4 dhe 6 të nenit 17 të kësaj Rregulloreje, zbatohen përshtatshmërisht dhe në këtë rast".

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, duke u bazuar në shkresat e lëndës ka konstatuar se kandidati i përzgjedhur nga testi me shkrim, jetëshkrimi dhe intervistimi me gojë ka grumbulluar gjithsej 77 pikë dhe është renditur i pari në listën përfundimtare ndërsa ankuesja nga testi me shkrim, jetëshkrimi dhe intervistimi me gojë është renditur e dyta në listën përfundimtare me gjithsej 68.76 pikë andaj bazuar në dispozitat ligjore të nenit 34

paragrafit 11 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyratë Publik ka përcaktuar se: *"Në përfundim të vlerësimit, kandidatët e vlerësuar me 70 për qind apo më shumë, të pikëve totale të vlerësimit, konsiderohen kandidatë fitues dhe renditen nga Komisioni i pranimit, sipas pikëve të marra, në listën e kandidatëve të suksesshëm.*

Kolegji, po ashtu ka konstatuar se Njësia e Burimeve Njerëzore në Komunën e Hanit të Elezit me datë 01.09.2022 ka publikuar Rezultatet e vlerësimit për grupin „Specialist të Arkitekturës” për pozitën „Zyrtar për Planifikim dhe Zhvillim,” në Komunën e Hanit të Elezit, duke listuar lidhur me rezultatet përfundimtare një kandidat me mbi 70 pikët e arritura, dhe si kandidat i suksesshëm është përzgjedhur që ka arritur gjithsejtë 77 pikët e përgjithshme, andaj Kolegji konstaton se publikimi është bërë në pajtim me nenin 9 dhe paragrafin 2 të nenit 25 të Rregullores (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, ku është theksuar se: *2.Kandidatët që janë vlerësuar me shtatëdhjetë (70) pikë e më shumë, janë kandidatë fitues.*”, andaj ankuesja në rastin konkret në bazë të kësaj dispozite nuk ka arritur mbi 70 pikë, që te jete kandidate fituese dhe te jetë e renditur në listën e kandidateve të suksesshëm .

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, ka shqyrtuar dëshmitë e ofruara dhe ka konstatuar se Komisioni i Pranimit me rastin e përzgjedhjes së kandidatit për grupin „Specialist të Arkitekturës ” për pozitën „ Zyrtar për Planifikim dhe Zhvillim,” në Komunën e Hanit të Elezit si kandidat i cili ka grumbulluar me së shumti pikë të përgjithshme me gjithsejtë 77 pikë, ka vepruar në pajtim me nenin 21, 22, 23 dhe 24 të Rregullores (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, ku përcaktohet se:” nenin 24. *Shuma e pikëve të përfituara nga se cili kandidat në se cilën nga hapat e vlerësimit, japin vlerësimin përfundimtar të kandidatit ”*, duke përzgjedhur kandidatin e suksesshëm nga kjo procedurë e rekrutimit, i cili posedon Diplomë me numër 113/17, e datës 08.02.2017, të lëshuar nga Kolegji AAB me të cilën dëshmohet se ka përfunduar studimet universitare në programin Arkitekture dhe ka fituar gradën „Bachelor i Arteve në Arkitekturë”, me date 20.11.2016, si dhe me përvojë të punës si në vijim: sipas kontratës për marrëveshje për shërbime të veçanta, me numër protokolli 4188/201 e lidhur me komunën e Hanit të Elezit, në kohëzgjatje nga data 05.06.2017, deri me datë 04.08.2017, në pozitën „ Arkitekt në Zyrën e Urbanizimit”; sipas kontratës për marrëveshje për shërbime të veçanta, me numër protokolli 02-3687/2018 e lidhur me Komunën e Hanit të Elezit, në kohëzgjatje nga data 01.05.2018 deri me datë 31.07.2018, në pozitën „Arkitekt në Zyrën e Urbanizimit”; sipas kontratës për marrëveshje për shërbime të veçanta, me numër protokolli 02-6403/2018 e lidhur me komunën e Hanit të Elezit, në kohëzgjatje nga data 01.08.2018 deri me datë 31.10.2018, në pozitën „Arkitekt në Zyrën e Urbanizimit”; sipas kontratës për marrëveshje për shërbime të veçanta, me numër protokolli 1566/2020 e lidhur me komunën e Hanit të Elezit, në kohëzgjatje nga data 28.02.2020 deri me datë 28.08.2022, në pozitën „Arkitekt në Zyrën e Urbanizimit”, sipas Kontratës për marrëveshje shërbime të veçanta, e lidhur me Komunën e Hanit të Elezit, me numër 659-21-11144-2-3-6/C184, nga data 14.04.2021 deri me datën 14.10.2021, sipas Kontratës së për marrëveshje shërbime të veçanta, e lidhur me komunën e Hanit të Elezit, me numër 659-22-2611-2-4/C240, nga data 14.04.2022, deri me datën 14.06.2022; sipas Kontratës së për marrëveshje shërbime, e lidhur me komunën e Hanit të Elezit, me numër 659-219304-2-4-7/C2228, nga data 22.11.2021, deri me datën 21.02.2022,

sipas Kontratës së për marrëveshje shërbime të veçanta, e lidhur me komunën e Hanit të Elezit, sipas Kontratës së për marrëveshje shërbime të veçanta e lidhur me komunën e Hanit të Elezit, nga data 12.01.2022, deri me datën 12.04.2022 me të cilat dëshmohet se ka kandidati fitues ka plotësuar kriteret e përcaktuara sipas konkursit të datës 29.04.2022 të shpallur nga Komuna e Hanit të Elezit për grupin „Specialist të Arkitekturës” për pozitën „Zyrtar për Planifikim dhe Zhvillim” të cilat kanë qenë „Arsimi i kërkuar: Diplomë/a e studimeve Universitare me të paktën 180 kredi/ECTS-së apo ekuivalente me to, në fushën e : arkitekturës dhe zhvillim hapësinor, Urbanistikës si dhe Përvoja e punës e kërkuar: Se paku (2) vite përvoja pune në fushën për të cilën zhvillohet procedura për plotësimin e pozitës së lirë të Punës

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, ka konstatuar se Zyra e Personelit në Komunë të Hanit të Elezit, me rastin e publikimit të rezultateve përfundimtare sipas formularit të nxjerrë nga Komisioni për pranim lidhur me rezultatin përfundimtar të datës 01.09.2022 dhe Raportit të sistemit SIMBNJ-së të datës 31.08.2022 rezultateve finale për pozitën: „Zyrtar për Planifikim dhe Zhvillim ” ka vepruar në pajtim me dispozitat e Ligjit Nr.6/L-114 për Zyrtarët Publikë, Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën Administrative dhe nenin 25 paragrafin 2 të Rregullores (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, ka konstatuar se Komisioni për pranim në Komunë të Hanit të Elezit, me rastin e nxjerrjes së Vendimit me numër protokolli 02/7565/2022 të datës 09.09.2022, ka korrigjuar Vendimin me numër protokolli 02/7296/2022 të datës 07.09.2022, duke vepruar në pajtim me nenin 50 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, ku përcaktohet se: *“Organi publik, në çdo kohë, sipas detyrës zyrtare apo sipas kërkesës, mund të korrigjojë gabimet drejtshkrimore, gabimet në përlllogaritje dhe pasaktësi të tjera të ngjashme, të dukshme, në një akt administrativ”*. Kolegji duke u bazuar në dëshmitë e ofruara ka konstatuar se në rastin konkret Komisioni i Pranimi ka bërë korrigjimin e aktit administrativ në kohën kur e ka kuptuar se është lëshuar gabimi teknik pa nënshkrimin e kryetares së komisionit, duke korrigjuar gabimin teknik gjegjësisht vendimi në përmbajtje ka qenë i njëjtë por vetëm është korrigjuar apo evituar lëshimi teknik lidhur me nënshkrimin e Kryetares së Komisionit andaj Komisioni me rastin e nxjerrjes së Vendimit me numër protokolli 02/7565/2022 të datës 09.09.2022 me të cilin e ka refuzuar si të pa bazuar ankesën e ankueses ka vepruar në pajtim me dispozitat e Ligjit NR. 06/L - 114 Për Zyrtarët Publikë dhe Ligjit Nr. 05/L -031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative dhe Rregullores (QRK) nr. 16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës dhe Rregulloren (QRK) nr. 16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, sepse ka vërtetuar drejtë gjendjen faktike dhe juridike.

Andaj, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ka konstatuar se procedura e rekrutimit gjegjësisht konkursi i shpallur nga Komunën e Hanit të Elezit sipas njoftimit të datës 29.04.2022 me afat të aplikimit nga data 20.05.2022 deri më datën 03.06.2022, për grupin „Specialist të Arkitekturës” për pozitën „Zyrtar për Planifikim dhe Zhvillim”, me numër reference RN000008821 është zhvilluar në pajtim me dispozitat ligjore të nenit 34 paragrafi 2 dhe 3 të

Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë dhe nenit 7 dhe 9 të Rregullores (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar nënin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe neni 132 paragrafi 2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/ Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda me numër A.nr.859/2022

Rushit **KAJTAZI**

Procesmbajtës

Malsore **GASHI - BAJRAKTARI**

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankueses
- Kryetarit të Komunës Hani i Elezit;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Komunën Hani i Elezit, dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.